

SV 1

SUVA SPRUCIMI, E REZISTENCËS SË LARTË

Shtresa e parë e suvasë në të gjitha zbatimet e suvasë, me teknikë të lartë

Përshkrimi i produktit:

Llaç i gatshëm industrial, me bazë çimentoje gri "Portland", inerte me granulometri të përzgjedhur kokrrize prej mermeri Dionisi, hidrogëlqere dhe aditivë të posaçëm për përmirësimin e adezivitetit në sipërfaqe të vështira.

Nevojitet përzierje vetëm me ujë. Kështu minimizohet koha e përgatitjes së materialit.

Përdorimet:

Përdoret si dorë e parë (me spruco ose spërkatje) në të gjitha teknikat dhe format e suvatimit, duke krijuar nënshtresën për zbatimin e shtresave të tjera të suvasë. I përshtatshëm si për sipërfaqet e jashtme, ashtu edhe të brendshme.

Zbatohet mbi tulla, blloqe çimentoje, elemente porobetoni (YTONG - ALFABLOCK etj.) sipërfaqe betoni (kolona - tavane - transversa etj.), gurë pllaka termoizoluese dhe materiale të tjera. Në raste sipërfaqesh veçanërisht të vështira, si p.sh. beton i lustruar, kërkohet shtimi i rrëshires MARMOLINE MP 20.



Avantazhet:

Cilësi e qëndrueshme - Rezistencë e lartë – Adeziviteti i shkëlqyer - Rezistencë ndaj lagështisë dhe ngricës - Përdorim në mjedise të brendshme dhe të jashtme - Lehtësi dhe shpejtësi zbatimi - Punueshmëri e shkëlqyer

Paketimi:

Thasë 40 kg - Paletë 1400 kg (35 thasë) - Thasë të mëdhenj 1000 kg
Gjithashtu në silo me kapacitet 12 – 18 – 22 m³ me makineri të posaçme vendosjeje

Magazinimi:

Kohëzgjatja maksimale e ruajtjes në paketim të pahapur dhe mjedis të thatë: 12 muaj nga data e prodhimit

Siguria dhe higjiena:


Përmban kryesisht materialet e zakonshme të ndërtimit, çimento dhe inerte, rrjedhimisht nevojiten të njëjtat masa të ruajtjes që vlejné për përdorimin e materialeve të mësipërme.

Standardet:

EN 998-1 (GP/CSIII)

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:

Madhësia e kokrrizës:	0-4 mm
Pesha e posaçme e llaçit të njomë:	1980 Kg/m ³
Rezistenca ndaj ngjeshjes pas 28 ditësh:	5,0 MPa (klasë CSIII) (EN 1015-11)
Rezistenca ndaj epjes pas 28 ditësh:	1,5 MPa (EN 1015-11)

 12 DoP: 025 MARMO-CPR
NORDIA S.A. Bul. "Kifisias", nr. 364, GR 15233, Halandri, Athinë, Greqi
EN 998-1 MARMOLINE SV 1 Suva mbushëse çimentoje (GP/CSIII) për përdorim të brendshëm ose të jashtëm
Reagimi ndaj zjarrit: <i>Kategoria A1</i> Përthithja e ujit: <i>W0</i> Koef. i shpërhapjes së avujve të ujit: $\mu = 10/25$ Ngjitja: $\geq 0,35 \text{ N/mm}^2$ (FPa) Densiteti/përçimi termik: ($\lambda_{10,i \text{ thatë}}$) <i>0,58 W/mK (tab. vlera mesatare; P=50%)</i> Substanca të rrezikshme: <i>NPD</i> Rezistenca (ndaj ngrirjes/shkrirjes, në vendin e synuar për përdorim): <i>Vlerësuar si e shkëlqyeshme, pas testeve laboratorike dhe në terren</i>

ZBATIMI:

Uji për përzierje:	6-7 kg (lt) ujë për një thes 40 kg
Konsumi:	Për veshjen e 1 m ² , me trashësi suvaje 0,5 cm, nevojiten rreth 6-8 kg llaç

Udhëzimet e përdorimit:

- Kontrolloni që sipërfaqja të jetë e pastër dhe pa materiale të kalbura, dhe njomeni
- Për rezultate më të mira për shtrimet e mëtejshme me suva, këshillohet vendosja e udhëzuesve dhe këndeve metalike MARMOLINE
- Përziëni mirë me dorë ose në betonierë, një thes me sasinë e duhur të ujit. Procesi thjeshtohet nëse përdorni makineri të posaçme që disponon kompania
- Sasia e ujit që hidhet është sipas rrjedhshmërisë që kërkoni të arrini
- Vendoseni në trashësi deri në 1 cm
- Llaçi duhet të spërkatet njëtrajtshëm në mur, ose me mistri, ose me anë të makinerisë
- Lageni sipërfaqen e suvasë brenda së njëjtës ditë, dhe sipas kushteve të motit, lageni rregullisht dhe për 2-3 ditët e ardhshme

KUJDES:

- Mos shtoni sasi të tepruara uji, pasi rrisni mundësinë të krijohen plasaritje dhe të ulet rezistenca.
- Mos e trazoni për shumë kohë materialin dhe përdoreni brenda gjysmë ore
- Mos e vendosni materialin me trashësi të madhe
- Kur bën shumë nxehtë gjatë muajve të verës, pas vendosjes rekomandohet t'i lagni sipërfaqet e suvatuara.
- Në rast se përdorni pistoletë me presion, gominat duhet të pastrohen mirë pas përfundimit të punës
- Nuk këshillohet përdorimi në kushte mjedisi, si ngricë apo valë të nxehti (temperatura e vendosjes: 5°C deri në 35°C)

Udhëzimet e përdorimit si më lart janë treguese për përdorimin e drejtë të produktit. Për hollësi të tjera dhe më të përpikta teknike mund t'i drejtoheni sektorit teknik të kompanisë

Ne garantojmë cilësinë e produktit, për sa i përket specifikimeve teknike, siç këto printohen në deklaratën e performancës (CE) dhe në fletën teknike. Kjo garanci mbulon rreptësisht dhe vetëm produktin që ofrohet, dhe në asnjë rast rezultatin përfundimtar pas përdorimit të tij, i cili varet në shkallë të lartë nga përvoja dhe cilësia e punës së secilit përdorues, si dhe nga kushtet e përdorimit. Rekomandohet që përdoruesi ta përdorë një herë produktin në përmasa të vogla për provë dhe, pasi të sigurohet për rezultatin, të vijojë me punën e mirëfilltë. Botimi i fletës aktuale teknike anulon çdo botim të mëparshëm të saj.